



GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

VRHOVNI SUD REPUBLIKE KOSOVA

SUPREME COURT OF THE REPUBLIC OF KOSOVA



65/2016

19.02.2016

Mbledhja e Përgjithshme e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës në të cilën ishin të pranishëm edhe gjyqtarët dhe përfaqësuesit tjerë nga EULEX-i, në bazë të nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e Reçullta, më 01.02.2016 jep këtë:

#### Mendim juridik

Pronari i patundshmërisë së shpronësuar ka të drejtë të paraqes ankesë kundër aktvendimit të organit shpronësues për caktimin e lartësisë së kompensimit për shpronësim në afat prej 30 ditësh, që nga momenti i pranimit të këtij aktvendimi, konform nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, dhe nenit 31 par.1, nenit 32 dhe nenit 54 të Kushtutës së Republikës së Kosovës.

#### Arsyetimi

Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka kërkuar dhënien e mendimit juridik lidhur me atë se kur duhet të fillojë afati për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit të organit shpronësues lidhur me caktimin e lartësisë së kompensimit për patundshmërinë e shpronësuar, konform dispozitës së nenit 36 të Ligjit nr.03/L.139, për shpronësimin e pronës së paluajtshme.

Lidhur me këtë çështje, Gjykata Supreme e Kosovës mendon se momenti i fillimit të afatit për paraqitjen e ankesës kundër aktvendimit të organit shpronësues për caktimin e lartësisë së

kompensimit, për ish pronarin e kësaj patundshmërie të shpronësuar, fillon prej ditës kur i njëjti e ka pranuar këtë aktvendim, e jo prej ditës kur në kuptim të nenit 36 të këtij ligji i njëjti vendim ka hyrë në fuqi, pas shpalljes në Gazetën Zyrtare të Kosovës, dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, në kuptim të nenit 11 par.6 lidhur me par.7 të Ligjit për Shpronësim. Parim universal në të gjitha procedurat ligjore është se afati për paraqitjen e ankesës kundër çdo vendimi fillon prej ditës kur personi të cilit i referohet ai vendim, e ka pranuar vendimin. Për këtë arsye Gjykata Supreme mendon se Ligji për Shpronësim përmban defekt ligjor kur momentin e fillimit të afatit për paraqitjen e ankesës në kuptim të dispozitave të lartpërmendura e lidh me ditën e shpalljes së vendimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë, pasi që ndër të tjera, qytetarët e rëndomtë vështirë është që të kenë qasje të rregullt në përcjelljen e Gazetave Zyrtare të Kosovës dhe gazetave tjera në Kosovë.


Qëndron fakti se Gjykata Kushtetuese me aktgjykimin e lartpërmendur ka dhënë mendim se neni 36 i Ligjit për shpronësimin është në përputhje me Kushtetutën, për çështjen se a është kompetente Gjykata Supreme e Kosovës apo gjykatat e shkallës së parë, për të vendosur lidhur me ankesat e palëve të paraqitura në procedurën e shpronësimit kur organ shpronësues është qeveria (neni 36.2), por jo edhe lidhur me atë se kur duhet të fillojë afati i paraqitjes së ankesës për ish pronarët e patundshmërisë së shpronësuar (neni 36.3) kështu që Gjykata Supreme mendon se ky aktgjykim i Gjykatës Kushtetuese nuk ka të bëjë me këtë çështje kontestuese.

Me dispozitën e nenit 31 par.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, garantoher mbrojtja e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organit tjetër shtetëror dhe bartësve të kompetencave publike. Ndërkaq, me nenin 32 të Kushtetutës, garantoher se secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtën ose interesat e saj /tij/ në mënyrën e përcaktuar me ligj. Me nenin 54 të Kushtetutës, po ashtu parashikohet se çdo kush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose të mohimit të ndonjë të drejte të paraparë me Kushtetutë ose Ligj, si dhe të drejtave tjera, me njerë efektive ligjore, nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur.

Gjykata Supreme e Kosovës mendon se nëse ish pronarët e patundshmërisë së shpronësuar do t'i njihej e drejta për paraqitjen e ankesës, prej momentit të shpalljes së aktvendimit për cakimin e lartësisë së kompensimit për shpronësim, në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetat me tirazh të madh në Kosovë, kjo do të ishte në kundërshtim edhe me nenin 6.1 të Konventës Evropiane për të

drejtat dhe Lirinë Themelore të Njeriut, ku përcaktohet se çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga gjykata e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila duhet të vendos për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile. Ish pronarit të patundshmërisë së shpronësuar me mundësinë e ofruar ligjore për paraqitjen e ankesës, i është cenuar e drejta për gjykim të drejtë pa iu dhënë mundësi t'i dorëzohet personalisht vendimi mbi caktimin e kompensimit për pasurinë e tyre të shpronësuar. Me këtë veprim juridik është shkelur neni 13 i Konventës në fjalë i cili garanton të drejtën për mjet efektiv lidhur me çështjen që ka të bëjë me caktimin e lartësisë së kompensimit për pronën e paluajtshme. Neni 36.3 i Ligjit për Shpronësim në këtë drejtim, është në kolizion edhe me nenin 1 të Protokollit 1 të kësaj Konvente, ku parashihet që Ligji Nacional i Shpronësimit duhet të jetë i qasshëm dhe preciz, dhe se ndërhyrja në të drejtat pronësore duhet të jetë e bazuar në ligj si dhe kjo ndërhyrje duhet të jetë masë e fundit për arritjen e qëllimit të parapare. Në fund, Gjykata Supreme mendon se me mos dorëzim personal të vendimit për caktimin e lartësisë së kompensimit, dhe me fillimin e afatit të paraqitjes së ankesës kundër këtij vendimi nga momenti i shpalljes së tij në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në njëri prej gazetave me tirazh të madh në Kosovë, ish pronari i patundshmërisë së shpronësuar është vënë në pozitë substancialisht të pafavorshme përballë organit shpronësues, i cili vet e administron dhe e boton këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, kështu që për t'u evituar kjo pozitë e pafavorshme e pronarit të pasurisë së shpronësuar, patjetër, të njëjtit duhet t'i njihet e drejta e paraqitjes së ankesës, prej ditës kur ai e pranon në dorëzim personal aktvendimin e organit shpronësues mbi caktimin e lartësisë së shpronësimit.

Prof. Dr. Fejzullah Hasani



Kryetar i Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës